Prishtinë, më 15 mars 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400

Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org

www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-199/24

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 mars 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes prej 209m², pjesë e parcelës Nr. P-70806056-00005-5 me sipërfaqe të përgjithshme 6552m², pronë e PSh Qendra per Rehabilitim dhe Rekreacion BANJE Istog me parashtrues

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të sipërfaqes prej 209m², pjesë e parcelës Nr. P-70806056-00005-5 me sipërfaqe të përgjithshme 6552m², pronë e PSh Qendra per Rehabilitim dhe Rekreacion BANJE Istog me parashtrues


Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 3 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e kanë bazuar vetëm në faktin se pjesa e parcelës nr 5-5 e cila është objekt i kërkesës në anën perëndimore kufizohet me parcelën 4-73 pronë private e kurse në evidencën kadastrale kjo parcelë evidentohet në emër të fëmijëve të tij me nga 1/3 e parcelës, perderisa në anën tjetër kjo pjesë e parcelës nr.5.5 në anën veriore dhe lindore kufizohet me rrugë dhe lindore kufizohet me rrugë faktike e cila është pjesë e parcelës 5-5. Në anën tjetër parashtruesi i kërkesës në këtë pjesë të parcelës për të cilën ka kërkuar blerjen e saj prej 209m² ka ndërtuar garazh nga konstruksioni metalikë dhe jo me bazë të fortë betoni. Një gjendje e tillë paraqitet edhe në vetë ekspertizën gjeodezike të dorëzuar nga pala. Parcela kadastrale e cila është objekt i kërkesës ka qasje të pa penguar direkte në rrugë publike.

Nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 15 mars 2024


Mentor Hyseu
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit


Tel: +383 (0) 38 500 400

Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org

www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



Nr. Ref. BD-199/25

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 mars 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës Nr. P-71813001-00574-0 me sipërfaqe të përgjithshme 8186 m², e cila gjendet në Zonen Kadastrale Atmaxhë, Komuna Prizren, pronë e NSh - KBI "Progres Export" Prizren me parashtrues

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të parcelës Nr. P-71813001-00574-0 me sipërfaqe të përgjithshme 8186 m², e cila gjendet në Zonen Kadastrale Atmaxhë, Komuna Prizren, pronë e NSh - KBI "Progres Export" Prizren me parashtrues

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negocim direkt sipas nenit 3 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e kanë bazuar vetëm në faktin se sipas deklaratës së palës, dhunshëm ju ishte marr kjo pronë paraardhësit të tij. Nga shkresat e lëndës nuk ka asnjë dëshmi me të cilën pala tregon se në cilëndo periudhë kohore prona e kërkuar ishte në pronësi të familjes apo paraardhësit të tij. Pala deklaroi se këtë parcelë e ka në posedim dhe e shfrytëzon ai por edhe në të kaluarën vazhdimisht e ka shfrytëzuar familja e tij.

Nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 mars 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-199/26

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 mars 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet Raporti Përfundimtar për shitjen e ngastrës kadastrale nr.02908-12 me sipërfaqe prej 217 m² dhe ngastrës kadastrale nr.02908-9 me sipërfaqe 24 m², ZK Mitrovicë, pronë e MIT002 KB "Agrokultura", në vlerë prej €20,000 me blerëse
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Përfundimtarë të Divizionit për Shitje Direkte në të cilin në të cilin rekomandohet miratimi për shitjen e ngastrës kadastrale nr.02908-12 me sipërfaqe prej 217 m² dhe ngastrës kadastrale nr.02908-9 me sipërfaqe 24 m², ZK Mitrovicë, pronë e MIT002 KB "Agrokultura", në vlerë prej €20,000. Blerësi:

Raporti Përfundimtarë i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore. Divizioni për Shitje Direkte ka ndjekur procedurat sipas rregullores në fjalë për shitjen e pronës së NSh-ve përmes procesit të shitjes direkte duke përfshirë përcjelljen për pajtueshmëri të palët të vlerësimeve të dorëzuara nga vlerësuesit e pavarur. Në raportin përfundimtar të prezantuar, janë përfshirë elementet qenësore të kësaj çështje juridike e cila përfshinë raportet e vlerësimit dhe vendimet relevante të Bordit të Drejtorëve lidhur me çështjen e vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bordi me datë 29 qershor 2023 kishte vendosur që për raportet e dorëzuara në AKP përgjatë viteve 2019, 2020 dhe 2021 të iniciohet vlerësimi në shkallë me të lartë. Si rezultati i këtij vendimi ky rast është dërguar në rivlerësim/vlerësim të shkallës së dytë dhe vlera e përcaktuar në raportin e vlerësimit të shkallës së dytë ka qenë 12,000€ (49.37 €/m² për sipërfaqen 217 m² dhe 48.47 €/m² për sipërfaqen 24 m²) dorëzuar në AKP me datë 13 tetor 2023. Bordi pastaj me datë 14 dhjetor 2023 ka vendosur që për këtë palë të iniciohet vlerësimi në shkallë të tretë. Andaj ky raport i paraqitur në dispozitiv të këtij vendimi është i instancës së tretë. Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padë pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 15 mars 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400

Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org

www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-199/27

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 mars 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet Raporti Përfundimtar për shitjen e lokalit afarist në përdheshë me sipërfaqe prej 66 m² në rrugën "Rrustem Hyseni" nr.3, 10000 Prishtinë, pronë e PRN103 NSH "Urata", në vlerë prej €57,500 me blerës

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi Propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Përfundimtar të Divizionit për Shitje Direkte në të cilin në të cilin rekomandohet miratimi për shitjen e shitjen e lokalit afarist në përdheshë me sipërfaqe prej 66 m² në rrugën "Rrustem Hyseni" nr.3, 10000 Prishtinë, pronë e PRN103 NSH "Urata", në vlerë prej €57,500. Blerësi:

Raporti Përfundimtarë i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore. Divizionit për Shitje Direkte ka ndjekur procedurat sipas rregullores në fjalë për shitjen e pronës së NSH-ve përmes procesit të shitjes direkte duke përfshirë përcjelljen për pajtueshmëri te palët të vlerësimeve të dorëzuara nga vlerësuesit e pavarur. Në raportin përfundimtarë të prezantuar, janë përfshirë elementet qenësore për secilën lëndë, përfshirë raportet e vlerësimit dhe vendimet relevante të Bordit të Drejtorëve lidhur me lëndët në fjalë.


Palajtshmëria objekt i kësaj çështje juridike ka pasur disa vlerësime duke filluar nga vlerësimi i dorëzuar 15.03.2021. Bordi në mbledhjen e 15 janar 2024 kishte vendosur që të inicioj për përsëritjen e Vlerësimit të shkallës së parë për shkak të vjetërsisë së raportit. Andaj ky raport i paraqitur në dispozitiv të këtij vendimi është i përsëritur.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 mars 2024



Mexitor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-199/28

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 mars 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet Raporti Përfundimtar për shitjen e ngastrës kadastrale nr.657-0 me sipërfaqe prej 37 m2, ZK Gjakovë, pronë e PEJ134 NT "Agimi", në vlerë prej €33,300 me blerëse

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi Raportin Përfundimtar të Divizionit për Shitje Direkte në të cilin në të cilin rekomandohet miratimi për shitjen e shitjen e ngastrës kadastrale nr.657-0 me sipërfaqe prej 37 m2, ZK Gjakovë, pronë e PEJ134 NT "Agimi", në vlerë prej €33,300. Blerësi:

Raporti Përfundimtarë i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore. Divizioni për Shitje Direkte ka ndjekur procedurat sipas rregullores në fjalë për shitjen e pronës së NSh-ve përmes procesit të shitjes direkte duke përfshirë përcjelljen për pajtueshmëri të palët të vlerësimeve të dorëzuara nga vlerësuesit e pavarur. Në raportin përfundimtarë të prezantuar, janë përfshirë elementet qenësore për secilën lëndë, përfshirë raportet e vlerësimit dhe vendimet relevante të Bordit të Drejtorëve lidhur me lëndët në fjalë.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padë pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 mars 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400

Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org

www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-199/29

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 mars 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Caktohet ekspertiza e tretë për rastin e shitjes së ngastrës kadastrale nr.02618-1 me sipërfaqe prej 3520 m2, ngastrës kadastrale nr.02618-2 me sipërfaqe 742 m2 dhe ngastrës kadastrale nr.02634-3 me sipërfaqe 760 m2, ZK Mitrovicë, pronë e MIT016 NSH "Betonjerka", me palën
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi Propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Përfundimtarë të Divizionit për Shitje Direkte në të cilin në të cilin trajtohet çështja e shitjes së pjesës së ngastrës kadastrale nr.02618-1 me sipërfaqe prej 3520 m2, ngastrës kadastrale nr.02618-2 me sipërfaqe 742 m2 dhe ngastrës kadastrale nr.02634-3 me sipërfaqe 760 m2, ZK Mitrovicë, pronë e MIT016 NSH "Betonjerka", në vlerë prej €39,000 me blerës

Raporti Përfundimtar i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore. Divizioni për Shitje Direkte ka ndjekur procedurat sipas rregullores në fjalë për shitjen e pronës së NSH-ve përmes procesit të shitjes direkte duke përfshirë përcjelljen për pajtueshmëri të palët të vlerësimeve të dorëzuara nga vlerësuesit e pavarur. Në raportin përfundimtarë të prezantuar, janë përfshirë elementet qenësore për secilën lëndë, përfshirë raportet e vlerësimit dhe vendimet relevante të Bordit të Drejtorëve lidhur me lëndët në fjalë.

Palutjshmëria objekt i kësaj çështje juridike ka pasur disa vlerësime duke filluar nga vlerësimi i dorëzuar 29.11.2019, plotësuar me 22.03.2021. Bordi në mbledhjen e 31.07.2023 kishte vendosur që raportin ta dërgoj në iniciimin e vlerësimit të shkallës së dytë.


Bordi konsideroi që çmimi i ekspertizës së dytë është më i ulët, nën mesataren e çmimeve të shitjeve paraprake nga agjencia për zonën e njëjtë kadastrale. Po ashtu, Bordi vlerësoi që është në interes të rritjes së vlerës së ndërmarrjes MIT016 NSH "Betonjerka", që rasti në fjalë të shkojë në ekspertizë të tretë.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 mars 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



Nr. Ref. BD-199-30

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 mars 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Caktohet ekspertiza e tretë për rastin e shitjen së ngastrës kadastrale nr.02448-3 me sipërfaqe prej 458 m2, ZK Gjilan, pronë e GJI003 NSh "IDGJ – Industria e Duhanit, me palën

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi Propozimin e menaxhmentit dhe Raportin Përfundimtar të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin në të cilin trajtohet çështja e shitjes së ngastrës kadastrale nr.02448-3 me sipërfaqe prej 458 m2, ZK Gjilan, pronë e GJI003 NSh "IDGJ – Industria e Duhanit, në vlerë prej €40,000 me blerës


Raporti Përfundimtar i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore. Divizioni për Shitje Direkte ka ndjekur procedurat sipas rregullores në fjalë për shitjen e pronës së NSh-ve përmes procesit të shitjes direkte duke përfshirë përcjelljen për pajtueshmëri të palët të vlerësimeve të dorëzuara nga vlerësuesit e pavarur. Në raportin përfundimtar të prezantuar, janë përfshirë elementet qenësore për secilën lëndë, përfshirë raportet e vlerësimit dhe vendimet relevante të Bordit të Drejtorëve lidhur me lëndët në fjalë.

Palutjshmëria objekt i kësaj çështje juridike ka pasur disa vlerësime duke filluar nga vlerësimi i dorëzuar me 05.12.2023 ku pala ka njoftuar me 13.12.2023 se nuk pajtohet me çmimin. Raporti pastaj është dërguar në iniciimin e vlerësimit të shkallës së dytë.

Bordi konsideroi që çmimi i ekspertizës së dytë është më i ulët, nën mesataren e çmimeve të shitjeve paraprake nga agjencia për zonën e njëjtë kadastrale. Po ashtu, Bordi vlerësoi që është në interes të rritjes së vlerës së ndërmarrjes GJI003 NSh "IDGJ – Industria e Duhanit që rasti në fjalë të shkojë në ekspertizë të tretë. Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 15 mars 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-199/31

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 mars 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Caktohet ekspertiza e tretë për rastin e shitjes së e $\frac{1}{2}$ të ngastrës kadastrale nr.00068-0 me sipërfaqe prej 11825 m², me sipërfaqe të përgjithshme prej 23650 m², ZK Fushë Kosovë, pronë e PRN009 NSH "Bujqësia", me palën

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi Raportin Përfundimtar të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin në të cilin trajtohet çështja e shitjes së e $\frac{1}{2}$ të ngastrës kadastrale nr.00068-0 me sipërfaqe prej 11825 m², me sipërfaqe të përgjithshme prej 23650 m², ZK Fushë Kosovë, pronë e PRN009 NSH "Bujqësia", në vlerë prej €50,900 me blerës

Raporti Përfundimtar i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore. për Shitje Direkte ka ndjekur procedurat sipas rregullores në fjalë për shitjen e pronës së NSH-ve përmes procesit të shitjes direkte duke përfshirë përcjelljen për pajtueshmëri të palët të vlerësimeve të dorëzuara nga vlerësuesit e pavarur. Në raportin përfundimtar të prezantuar, janë përfshirë elementet qenësore për secilën lëndë, përfshirë raportet e vlerësimit dhe vendimet relevante të Bordit të Drejtorëve lidhur me lëndët në fjalë.

Palujtshmëria objekt i kësaj çështje juridike ka pasur disa vlerësime duke filluar nga vlerësimi i dorëzuar me 08.11.2023 ku pala ka njoftuar me 08.12.2023 se nuk pajtohet me çmimin. Raporti pastaj është dërguar në inicimin e vlerësimit të shkallës së dytë.

Bordi konsideroi që çmimi i ekspertizës së dytë është më i ulët, nën mesataren e çmimeve të shitjeve paraprake nga agjencia për zonën e njëjtë kadastrale. Po ashtu, Bordi vlerësoi që është në interes të rritjes së vlerës së ndërmarrjes PRN009 NSH "Bujqësia", që rasti në fjalë të shkojë në ekspertizë të tretë.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 15 mars 2024



Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



Nr. Ref. BD-199-32

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 mars 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Caktohet ekspertiza e tretë për rastin e shitjes së ngastrës kadastrale nr.00670-1 me sipërfaqe prej 836 m², ngastrës kadastrale nr.00670-2 me sipërfaqe 408 m², ngastrës kadastrale nr.00670-3 me sipërfaqe 389 m² dhe ngastrës kadastrale nr.00670-4 me sipërfaqe 430 m², ZK Prishtinë, pronë e PRN009 "Bujqësia", me palët dhe
- II. Ky vendim nyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi Raportin Përfundimtar të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin në të cilin trajtohet çështja e shitjes së ngastrës kadastrale nr.00670-1 me sipërfaqe prej 836 m², ngastrës kadastrale nr.00670-2 me sipërfaqe 408 m², ngastrës kadastrale nr.00670-3 me sipërfaqe 389 m² dhe ngastrës kadastrale nr.00670-4 me sipërfaqe 430 m², ZK Prishtinë, pronë e PRN009 "Bujqësia", në vlerë prej €54,587 me blerësit:

Raporti Përfundimtarë i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore. Divizioni për Shitje Direkte ka ndjekur procedurat sipas rregullores në fjalë për shitjen e pronës së NSH-ve përmes procesit të shitjes direkte duke përfshirë përcjelljen për pajtueshmëri të palët të vlerësimeve të dorëzuara nga vlerësuesit e pavarur.

Palutjshmëria objekt i kësaj çështje juridike ka pasur disa vlerësime duke filluar nga vlerësimi i dorëzuar me 23.02.2021, ku rasti kishte shkuar në rivlerësim. Raporti i instancës së dytë është dorëzuar me datë 18.09.2023, plotësuar sipas kërkesës së datës 10.10.2023, 27.10.2023, 31.10.2023 dhe ai përfundimtar i datës 21.11.2023, që iu prezantuar Bordit në këtë mbledhje me shumicë në vlerë prej €54,587.

Bordi konsideroi që çmimi i ekspertizës së dytë është më i ulët, nën mesataren e çmimeve të shitjeve paraprake nga agjencia për zonën e njëjtë kadastrale. Po ashtu, Bordi vlerësoi që është në interes të rritjes së vlerës së ndërmarrjes PRN009 NSH "Bujqësia", që rasti në fjalë të shkojë në ekspertizë të tretë.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 15 mars 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-197/33

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 mars 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Përsëritet vlerësimi i palujtshmerisë që nga niveli fillestar për shitjen e pjesës 16/18 të ngastrës kadastrale nr.6512-0 me sipërfaqe sipas kërkesës për blerje të
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Përfundimtar të Divizionit për Negocim Direkte në të cilin trajtohet çështja e shitjes së pjesës 16/18 të ngastrës kadastrale nr.6512-0 me sipërfaqe prej 4885 m², ZK Prizren, pronë e NSh PRZ009 "Lavërtaria", në vlerë prej 36,200€. Blerësi:

Raporti Përfundimtar i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregullores Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Divizioni ka ndjekur procedurat sipas rregullores në fjalë për shitjen e pronës së NSh-ve përmes procesit të shitjes direkte duke përfshirë përcjelljen për pajtueshmëri të palët të vlerësimeve të dorëzuara nga vlerësuesit e pavarur.

Palujtshmëria objekt i kësaj çështje juridike ka pasur disa vlerësime duke filluar nga vlerësimi i dorëzuar me 04.03.2020 me vlerë, 122,125.00€. Vlerësimi i dytë ka qenë me datë 18.08.2020 në vlerë 31,750€, ndërsa Vlerësimi i tretë është iniciuar nga Bordi me datë 29.06.2023 për shkak të vjetërsisë (raporte të viteve 2009, 2020, 2021). Raporti i tretë i vlerësimit është dorëzuar në mbledhjen e datës 28.09.2023 në vlerë prej 36,200€. Bordi kishte lëshuar udhëzim në mbledhjen e datës 15.11.2023 që për rastin/kërkesën e

Menaxhmenti/Divizioni për shitje Direkte u udhëzua që të shkruaj Këshillit Mbikëqyrës nëse të tri raportet e vlerësimit për këtë rast janë në përputhje me standardet dhe Kodin e Etikës. Vendimi për rastin e u shtya deri sa nuk merr vendim/përgjigje nga Këshilli. Drejtori Ekzekutiv iu është adresuar Këshillit me datë 06.12.2023, ndërsa AKP përgjigjen e Këshillit për Mbikëqyrje dhe licencim të vlerësuesve të pronave të paluajtshme e ka pranuar me datë 01.03.2024 me anë të cilës përgjigje Këshilli ka bërë me dije që të tri raportet e vlerësimit për rastin në fjalë nuk përmbajnë referenca të mjaftueshme rreth opinionit të dhënë sa i përket vlerës së pronës dhe duhet të plotësohen nga ana e tyre.

Bordi ka shqyrtuar raportet dhe duke pas parasysh diferencën e madhe në vlerësime, krahasimet jo të duhura, përgjigjen e Këshillit, konstatoi se është thyer besimi në vlerësimet e shtatë (7) vlerësuesve që kanë marr pjesë në tre (3) nivelet e vlerësimit.

M.H.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO


Bordi vlerësoi që është në interes të transparencës së përgjithshme dhe të ndërmarrjes NSh PRZ009 "Lavërtaria" që rasti në fjalë të shkojë në ekspertizë fillestare të vlerësimit. Duke marrë parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 mars 2024.




Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës